REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

INFORMACION KONFIDENCIAL

NE LIDHJE ME NGJARJEN E DATES 21.01.2011

Pas keqyrjes se vendit te ngjarjes dhe kryerjes se shume ekspertimeve balistike, ne perfundim, pasi jane identifikuar te gjitha armet per te gjitha gezhojat e gjetura ne vendin e ngjarjes ka rezultuar se nga moria e gezhojave dhe plumbave te kalibrit 9x19mm te gjendur ne vendngjarjen e eventeve te dates 21.01.2011, vetem 11 gezhoja (me markirim te vecante **"MKE 9mm MP-5"**) kane rezultuar te qitura nga pistoleta tip "Beretta" model 92-FS me numer P52796Z. Kurse nga gjithe predhat me vlera identifikuese te gjendur ne vendin e ngjarjes, vetem njera prej tyre ka rezultuar te jete qitur nga pistoleta tip "Beretta" model 92-FS me numer P52778Z, por nuk ka rezultuar asnje gezhoje !!! Gjithe gezhojat e tjera te kalibrit 9x19mm, te gjendura ne vendin e ngjarjes, pas kryerjes se ekspertimeve balistike kane rezultuar te jene qitur nga automatike model MP-5.

Paraprakisht duhet thene se gjithe municioni 9x19mm (Parabellum) i perdorur aktualisht nga efektivet e Gardes se Republikes dhe Policise se Shtetit dhe i gjendur ne vendngjarje eshte prodhim shqipetar i Kombinatit Mekanik Polican (K.M.P), i cili vleresohet prej perdoruesve si jo shume cilesor si persa i perket materialeve te perdorur, fortesise se kapsolles si edhe saktesise se qitjes.

Perseri vlen te theksohet edhe fakti se 11 geshojat e gjendura ne vendin e ngjarjes, te qitura nga pistoleta tip **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52796Z** kane markirimin **"MKE 9mm MP-5"**, sipas te cilit kuptohet se eshte prodhim i korporates turke **"Makina ve Kimya Endustrisi Kurumu"**, e cila mban siglen M.K.E. ose M.K.E.K. . Te po ketij

prodhimi jane edhe gjithe automatiket model MP-5, ne disponim te Gardes se Republikes, te cilet jane dhurate e Qeverise Turke, ne kuader te bashkepunimit dypalesh. Prej ketej rrjedh se keta lloj fishekesh jane municionet fillestare, qe kane shoqeruar dhurimin e automatikeve turq, e prej ketej deduktojme se keta lloj fishekesh, per shkak te cilesive te tyre jane te ralle dhe shume te kerkuar.

Pistoleta tip **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52796Z,** eshte arme armatim personal ne disponim te komandantit te Gardes se Republikes z. Ndrea Prendi, i cili eshte i vetmi qe kishte ne disponim kete lloj municioni. Pas angazhimit tone per marrjen e modeleve krahasuese nga i njejti lloj municioni, ky municion prodhim turk M.K.E.K, u gjet ne nje depo 240 km larg kryeqytetit Tirane.

Pistoleta **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52796Z**, e cila eshte ne perdorim te komandantit te Gardes se Republikes z. Ndrea Prendi rezulton te kete qitur 11 gezhojat me markirim **"MKE 9mm MP-5"**, te gjendur ne vendin e ngjarjes. Keto gezhoja jane identifikuar si te qitura nga kjo pistolete duke bazuar tek gjurmet e lena ne gezhoje nga grepi nxjerres ne momentin e nxjerrjes nga foleja pas kryerjes se qitjes. Gjurmet e lena nga gjilpera e pistoletes **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52796Z** ne modelet krahasuese nuk perputhen me ato te gjendura tek gezhojat e gjetura ne vendin e ngjarjes, kjo ne rruge konfidenciale nga ekspertet teknikobalistike, shpegohet me faktin se gjilpera e pistoletes ne momentin kur eshte bere egzaminimi balistik ka qene e perpunuar mekanikisht (goditur). Ky fakt nuk eshte permendur ne aktin e ekspertimit perkates, kjo pasi ekspertet ne menyre konfidenciale shprehen se druhen nga nje "hakmarrje" eventuale.

Pistoleta **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52778Z**, e cila eshte ne perdorim te shoferit personal te komandantit te Gardes se Republikes z.Ndrea Prendi, rezulton te kete qitur nje predhe, e cila eshte gjendur e futur ne nje peme te gjendur ne krahun e djathte (kur i qendron perballe) te godines se ish Komitetit Qendror. Flurudha e kesaj predhe, duke pare edhe gjurmen e lene ne peme duhet te kete qene ne lartesi

njeriu, ne pjesen e saj mbi bulevard. Po keshtu edhe **predha e gjendur ne trupin e viktimen Faik Myrto**, i cili eshte vrare pak metra larg pemes ku eshte gjetur predha e identifikuar si e qitur nga pistoleta **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52778Z**, po sipas burimeve konfidenciale te eksperteve teknikobalistik **me nje probabilitet prej 60% duhet te jete qitur nga e njejta pistolete "Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52778Z**. Ky hezitim ne identifikimin e armes qitese, po sipas te njejtit burim vjen si rrjedhoje e nje paregullesie te lehte ne gjurmen e vjaskave e cila mendohet te jete pasoje e papastertive te gjendura ne tyten e armes, duke qene se kjo predhe duhet te jete qitur e para ose, per mendimin tim edhe per faktin se per modele krahasuese jane perdorur predha jo te njejta me ato te qitura nga kjo pistolete ne ngjarjen e dates 21.01.2011, por prodhim vendas i K.M.P. .

Duke i pare me sy te lire, por ne menyre shume te kujdeseshme te dy pistoletat vihet re se pistoleta **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52778Z** ka shenja me te lehta ose me pak gjurme, qe vijne si pasoje e perdorimit sesa pistoleta **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52796Z**. Keto gjurme vihen re si ne pjesen e jashteme te dy pistoletave ashtu si edhe ne pjesen e brendeshme te saj.

Cuditerisht tyta e gjendur ne pistoleten **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52778Z** mbart me shume gjurme qe vijne si pasoje e perdorimit sesa tyta e gjendur ne pistoleten **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52796Z**.

Pervec ketyre, me sy te lire dhe me shume vemendje tek tyta e pistoletes **Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52796Z**, ne anen e djathte te tytes, aty ky mbarojne shenjat e koalidimit te saj fillon nje gervishtje e lehte me zbulim te metalit poshte bojes, e cila zgjatet disa cm deri sa futet ne brendesi te djepit luajtes, ndersa djepi luajtes i kesaj pistolete ne pjesen e brendeshme te tij, ka nje imperfeksion shume te lehte, i cili eshte i ferkuar shume shume pak, i cili nuk mund te kete krijuar kete gervishtje.

Djepi luajtes i pistoletes **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52778Z,** ne pjesen e brendeshme te tij ka nje imperfeksion mekanik (e dale e vogel ne forme grepi, i cili te jep pershtypjen se eshte ferkuar me

tyten shume me teper se ai i pistoletes tjeter, por ne fakt ka krijuar nje gjurme shume me te vogel.

Duhet thene se gjithe pistoletat "Beretta" model 92-FS, te gjendura ne posedim te Gardes se Republikes se Shqiperise jane te identifikuara nepermjet numrit serial te perbere prej dy germash dhe pese shifrash, te vendosur vetem nje here te vetme ne trupin e pistoletes. Gjithe pjeset perberese te tjera te kesaj tipi pistolete jane te paidentifikueshme dhe plotesisht te perputheshme per montim dhe nderrim ne pistoleta te tjera te njejtit tipi. Duke patur parasush kete fakt si edhe gjithe faktet e renditura me lart natyrshem lind dyshimi se tyta e pistoletes **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52778Z** dhe ajo e pistoletes **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52796Z** duhet te jene nderruar me njera tjetren.

Per te qene sa me i kuptueshem me duhet te pershkruaj ne menyre te hollesishme balistiken e brendeshme te pistoletes, si vijon:

Me terheqjen e kembezes rahesi godet gjilperen, e cila godet kapsollen e fishekut, i cili gjendet ne folene e fishekut, e cila eshte pjese perberese e pandashme tytes, qe ne kete rast eshte monobllok. Pas detonimit mekanik te kapsolla ndez barrutin dhe brenda fishekut krijohet nje presion shume i madh. Si pasoje e kesaj trysnie dhe temperature shume te madhe, e cila eshte progresive deri ne momentin e daljes se predhes jashte tytes, cilindri i gezhojes puthitet fort pas folese se fishekut duke mare formen e folese dhe duke krijuar nje guarnicion te vertete. Ne kete menyre siperfaqja e jashteme cilindrike e gezhojes merr formen identike te folese se fishekut, ndersa siperfaqje e shehte e pasme ngjeshet pas mekanizmit mbajtes se gjilperes. Me aktivizimin e sistemit inercial gezhoja e kapur nga grepi nxjerres, i gjendur ne djepin luajtes, meret mbrapa e me pas hidhet jashte. Gjate rruges se kthimit djepi luajtes mer nga karikatori ose kreheri fishekun e radhes dhe e fut ne fole, duke e bere armen te afte te realizoje nje qitje tjeter.

Si pasoje e djegjes se barutit, brenda gishekut clirohet nje temperature dhe trysni e tille, e cila puthit fort pas mekanizmit mbajtes se gjilperes siperfaqen e pasme, te sheshte te gezhojes dhe meqenese kjo sipergaqe eshte shume e treshe ne krahasim me pjesen tjeter te gezhojes, ne

kete rast vetem kapsolla duke qene shume me e holle dhe rrjedhimisht e bute mer formen identike te ketij mekanizmi.

Po keshtu edhe siperfaqja e jashteme cilindrike e gezhojes si pasoje e trysnise dhe temperatures puthitet shume fort pas folese duke bere, qe ajo te mare formen identike te folese se fishekur. Kjo siperfaqe krijon nje guarnicion te vertete dhe ne kete menyre mbart shenja te formes se folese se fishekur, te cilat gjate nxjerrjes nga foleja mund te shnderohen ne gjurme mekanike te vlefshem per identifikim.

Këtij ekzaminimi duhet t'i nënshtrohen gëzhojat e gjetura në vendin e ngjarjes dhe gëzhojat modele krahasimi për pistoletat **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52778Z** dhe **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52796Z** me qellim identifikimin e tytes ku eshte bere plasja e 11 gezhojave te gjendura ne vendin e ngjarjes, mbasi ekzistojnë dyshime te aresyeshme se tytat e këtyre armëve janë ndërruar me njëra tjetrën.

Po keshtu per te qene sa me qarte ne rezultatet e ekspertimit teknikobalistik eshte arritur, qe edhe predhat dhe gezhojat, modele per krahasin, te jene te te njejtit lloj (markirimi **"MKE 9mm MP-5")**

Gjithashtu kerkohet te egzaminohen pistoletat **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52778Z** dhe **"Beretta" model 92-FS cal. 9** me numer **P52796Z** nese ka manipulim ose nderrim te pjeseve te tyre funksionale, duke u bazuar ne gjurmet e lena si pasoje e ferkimit te pjeseve perberese gjate funksionimit te pistoletes.

Po keshtu ketij egzaminimi duhet ti nenshtrohen predhat e gjendura ne vendin e ngjarjes dhe predhat modele krahasimi me qellim identifikimin e qarte te armes qitese.